

Variante:

Vetëportret ose profili personal me qendër gjuhët (gjuha ime e parë, cilat gjuhë të tjera i di, çfarë gjuhësh fliten në mjedisin ku jetoj unë etj.)

Udhëzime për literaturën

Informacione të thelluara nga «zbuluesi» i portretizimit të gjuhëve, prof. Hans-Jürgen Krumm nga Viena i gjeni në vjeggzën http://www.akdaf.ch/html/rundbrief/rbpdfs/61_Mehrsprachigkeit_Sprachenportraits.pdf

3.2 Projekte dy-ose shumëgjuhësore

Qëllimi

Në projektet dy ose shumëgjuhësore me shkrim nxënësitet e MGJP bëhen të vetëdijshëm për burimet dhe mundësitë tyre. Duke u nisur nga gjuha e parë, krijohen raste autentike në të cilat mund të përkrahet kompetenca në të shkruar. Motivimit i ndihmon edhe krijimi i produkteve tërheqëse.

kl. 3–9

30–60 min.



Materiali:

Në varësi të projektit.

Udhëzim:

- Në qendër të MGJP qëndron realizimi i projektit në gjuhën e parë (edhe pse disa N ndihen më të sigurt në gjuhën e vendit mikpritës). Versioni në gjuhën e dytë apo gjuhën e vendit mikpritës ndodh në një hap të dytë.
- Bashkëpunimi me mësimin e rregullt është veçanërisht i frytshëm dhe i dobishëm në këto projekte. Tekstet dygjuhëshe, që krijohen këtu janë ideale për zgjerime shumëgjuhësore; krahaso këtu idetë nr. 21 dhe 22 në fletoren «Përkrahja e të shkruarit në gjuhën e parë».

Rrjedha:

- Klasa njoftohet për planifikimin e një projekti dygjuhësor ose shumëgjuhësor; marrëveshja e përbashkët në lidhje me temën, llojin e tekstit dhe produktin që do të krijohet aty. N duhet të kenë kuptuar se bëhet fjalë për përdorimin e aftësive të tyre në dy gjuhë.
- Temat e mundshme dhe produktet:
 - Niveli i ulët: modelimi i një libri të ilustruar dygjuhësh (poshtë teksti në gjuhën e parë, lart në gjuhën e dytë). Ilustrimet bëhen ose nga vetë fëmijët (për një tregim që e gjejnë vetë ata ose nga një tregim që ua ka lexuar M), ose M ua jep modelin e gatshëm për ta ngjitur në fletore (p.sh. një tregim të ilustruar). Variante: Të modelohet një «mini-libër»; krahaso broshurën «Përkrahja e të shkruarit në gjuhën e parë», nr 21.2 dhe 22.4; Vjeggza: <http://www.minibooks.ch/>.
 - Niveli i ulët dhe i mesëm: Poezi dygjuhëshe për një temë apo një formë letrare (p.sh. «poezi njëmbëdhjetëshe», shih broshurën «Përkrahja e të shkruarit në gjuhën e parë», Nr 21.1). Tekstet e krijuara pastaj mund të modelohen bukur dhe në letër me ngjyrë të lidhen në një libërth.
 - Niveli i mesëm: modelimi i një libri-aventurë dygjuhësh, krahaso broshurën «Përkrahja e të shkruarit në gjuhën e parë», Nr 21.2.
 - Niveli i mesëm dhe i lartë: Përmbledhje dygjuhëshe (receta kuzhine, receta artizanale, shaka, gjëgjëza, etj). Të mblidhen në një fletore ose dosje; eventualisht të shumëzohet dhe të dekorohet.

- Niveli i mesëm dhe i lartë: Modelimi i kopertinave të një libri dhe të tekstit të ballinës (ose dygjuhësor ose krahas në gjuhën e parë dhe në gjuhën e shkollës); krahaso: <http://www.sikjm.ch/literale-foerderung/abgeschlossene-projekte/mein-buchumschlag/> dhe <http://www.sikjm.ch/medias/sikjm/literale-foerderung/projekte/mein-buchumschlag-di-daktische-anregungen.pdf>.
- Niveli i mesëm dhe i lartë: modelimi i një «romani fotografish» dygjuhësh ose shumëgjuhësh me fotot e bëra vetë dhe me fluskat e fjalëve. Përpunimi bëhet më së miri në kompjuter. Shih. Broshura «Përkrahja e të shkruarit në gjuhën e tyre të parë», nr. 22.3.
- Niveli i mesëm dhe i lartë: Gazetë dygjuhëshe e nxënësve/eve (Gazetë muri, Gazeta e lidhur në format A4, gazetë elektronike).

3.3 Tema biografike gjuhësore

Qëllimi

Ballafaqimi me të rriturit në dhe mes dy gjuhëve forcon kompetencën e reflektimit dhe njohuritë për veçoritë e biografisë së vet dhe kompetencës personale. Tema është tërheqëse dhe ndihmuese nëse lidhet drejtpërdrejt me përvojat dhe kujtimet personale.

kl. 2–9

30–45 min.



Materiali:
Varësisht nga lloji i zbatimit
(A-2-letër për poster).

Udhëzime:

- Në të shumtën ekzistojnë si gjuha e parë ashtu edhe ato të vendit mikpritës në varantet dialektore dhe në formën standarde. Natyrisht, të gjitha duhet të tematizohen. (Më së shumti vështirësi kanë nxënësit/et me variantin standard të gjuhës së parë.)
- Tema mund të trajtohet për çështje të ndryshme, duke ia përshtatur moshës. Është mjaft e mundur që grupet e niveleve të ndryshme të punojnë paralelisht për çështje të ndryshme dhe në vazhdim t'i paraqesin rezultatet e tyre.
- Në raste normale projekti do të shpërndahet në dy javë (hyrja në javën e parë, zhvillimi në të dytën). Një pikënisje të mirë përbëjnë «skicat gjuhësore», shih më lart 3.2.

Rrjedha:

- M i informon N në lidhje me projektin, formulon pyetjet e sakta (ndoshta për secilën grup-moshë një pyetje tjetër, shih më lart) dhe jep udhëzime të qarta për punë të mëtejshme (p.sh. për të marrë informacionet e kërkuara deri në javën e ardhshme, si dhe për t'i sjellë shënimet përkatëse). Një listë e pyetjeve të mundshme mund të gjendet më poshtë.
- Në javën tjetër rezultatet e detyrave të dhëna do të sistemohen, eventualisht të përmbledhen në formë të shkruar në një poster dhe të paraqiten në klasë. Në varësi të boshtit mund të përfundojë me një tekst të shkruar, ose me një diskutim në të cilin N i pasqyrojnë përvojat e tyre të cilat ata i kanë fituar në këtë projekt.
- Pyetje të mundshme:
 - Për të gjitha nivelet: Fjalët dhe fjalitë e mia të para në gjuhën e parë dhe të dytë (të pyetet edhe në shtëpi!); gabimet qesharake dhe aksidentale në gjuhën e parë dhe të dytë (e kuptuar gabimisht dhe e zbatuar); njerëz të rëndësishëm gjatë të mësuarit të gjuhës së parë dhe të dytë.